

RIMËKËMBJE, GJITHPËRFSHIRJE, QËNDRUESHMËRI

Buletini nr. 05 —————>

DHJETOR 2021



RINGJALLJE

INVESTIM

MBËSHTETJE

QËNDRUESHMËRI

KOORDINIM

PUNËSIM

MIRËQENIE

BARAZI

JETËSIM

EKONOMI

Masa 3

Mbështetja për familjen

Për buletin

INDEP përmes monitorimit të masave të Pakos së Ringjalljes Ekonomike synon të informojë shpejtë dhe drejtë qytetarët e Republikës së Kosovës. Informatat paraqiten për publikun përmes buletineve, infografikave, analizave dhe raporteve monitoruese në kuadër të projektit “Rimëkëmbje për Qëndrueshmëri”. Edicioni i pestë i buletinit “Rimëkëmbje, Gjithpërfshirje, Qëndrueshmëri” ka temë trajtimi masën e tretë të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Niveli i zbatimit, procesi, pritjet dhe arritjet do të shtjellohen përmes këtij buletini.


Masa e tretë e Pakos së Ringjalljes Ekonomike quhet Mbështetja për familjen. Epiqendra e gjithë shoqërisë është familja, andaj edhe dëmet e shkaktuara si pasojë e pandemisë COVID-19 janë të mëdha për këtë kategori. Ashtu si edhe pakot paraprake edhe pako aktuale e masave për rimëkëmbje ekonomike synon të ofrojë mbështetje dhe të mbulojë dëmet dhe problemet që ende janë evidente në familjet kosovare. **50 milionë Euro** është shuma e paraparë që të shfrytëzohet për të ndihmuar ngritjen e mirëqenies, tejkalimin e problemeve dhe mundësimin e zhvillimit të mëtutjeshëm të kategorisë në fjalë.

→ ÇKA OFRON MASA E TRETË E PAKOS SË RINGJALLJES EKONOMIKE?

Pandemia COVID-19 ka treguar se si dobësitë në sistemet shëndetësore mund të kenë implikime të thella për shëndetin, zhvillimin ekonomik, besimin tek qeveritë dhe mirëqenien sociale. Përhapja e COVID-19 prek të gjitha shtresat e popullsisë dhe është veçanërisht e dëmshme për anëtarët e atyre grupeve sociale që janë në gjendje më të cenueshme. COVID-19 vazhdon të prekë popullsinë, duke përfshirë njerëzit që jetojnë në situata varfërie, personat e moshuar, personat me aftësi të kufizuara dhe të rinjtë. Prandaj është e rëndësishë së madhe që grupeve të tilla të i kushtohet vëmendje e shtuar dhe të i'u ofrohet mbështetje maksimale.

Krahas dëmeve ekonomike, dëmet shëndetësore dhe psikologjike të pandemisë COVID-19 kanë afektuar të gjitha shtresat e popullësisë. Edhe në Kosovë, së bashku me përhapjen e virusit, u përhapën edhe shumë probleme dhe rreziqe të cilat thuhetse kanë prekur secilën familje kosovare. Humbja e më të dashurve, rrezikimi i vendeve të punës, vështirësitë e shtuara të familjeve me asistencë sociale dhe dëmtimi i likuiditetit familjar janë disa nga pasojat e pandemisë. Andaj, për të adresuar dhe mbështetur këto probleme, në Pakon e Ringjalljes Ekonomike u inkuadrua edhe masa e tretë e quajtur Mbështetja për familjen, e cila me gjashtë nënmasat e saj synon që të lehtësojë këto probleme. Gjashtë nënmasat e masës së tretë janë:

1. Mbështetja për familjet që kanë humbur kryefamiljarin
2. Mbështetja për pensionistët dhe familjet me asistencë sociale
3. Reformimi i Skemës së Asistencës Sociale
4. Kuponë ushqimi për familjet në nevojë
5. Pagesa për lehonat e papuna
6. Mbështetja e likuiditetit familjar



NËNMASA 3.1 → MBËSHTETJA PËR FAMILJET QË KANË HUMBUR KRYEFAMILJARIN

Infektimi me virusin COVID-19 shkakton komplikime shëndetësore e si rrjedhojë mund të shkaktojë edhe vdekjen. Mbylljet e deri më tashme, distancimi social dhe ndërprerja e zhvillimit të aktiviteteve normalisht, ishin të gjitha si rrjedhojë e parandalimit të komplikimeve shëndetësore të qytetarëve. Duke ditur rrezikun e paraqitur, edhe masat e marra nga ana e Qeverisë së Kosovës përkonin me mbrojtjen e shëndetit publik. Edhe pakot financiare në kuadër të lehtësimit të vështirësive të pandemisë përmbanin masa të cilat ndihmonin qytetarët që të tejkalojnë më lehtë pandeminë.

Pako e Ringjalljes Ekonomike, përkatësisht masa e tretë e kësaj pako alokon mjete për të ndihmuar familjet kosovare. Gjithsej ka të ndara **50 milionë Euro** përmes të cilave Qeveria e Kosovës synon ngritjen e mirëqenies sociale, lehtësimin e barrës së pandemisë dhe krijimin e një zhvillimi ekonomik më të mirë për të gjithë qytetarët e vendit. Nënmasa e parë e kësaj mase ka për qëllim të ndihmojë familjet të cilat e përjetuan pandeminë më së vështiri.

Nënmasa e parë e masës së tretë, e quajtur Mbështetja për familjet që kanë humbur kryefamiljarin synon të mbështesë me një shumë monetare të gjitha familjet që kanë humbur kryefamiljarin e tyre nga COVID-19. Duke e ditur që për shumë familje humbja e më të dashurve mund të ketë nënkuptuar edhe humbjen e burimit të vetëm të të ardhurave, një masë e tillë paraqet një ndihmesë e cila do të sigurojë mbulimin e disa prej shpenzimeve të cilat janë të domosdoshme. Operacionalizimi i kësaj mase tashmë ka ndodhur dhe aplikimi për personat përfitues ka qenë i hapur deri me datë 30 nëntor 2021. Për këtë nënmasë janë të ndara **4 milionë Euro**.

Cilat janë përfitimet e nënmasës së parë të masës së tretë?

Secilës familje që ka humbur familjarin si pasojë e infektimit me COVID-19 do t'i ofrohet mbështetje financiare në vlerë prej 1,500.00 Euro. Ndërsa subvencionimi për familjet të cilat pas datës 1 tetor 2021 kanë humbur familjarin nga infektimi me COVID-19 mund të përfitojnë mbështetje nga masa 3.1, vetëm nëse familjari i vdekur ka qenë i vaksinuar me të dy dozat e vaksinës kundër COVID-19. Sipas statistikave, deri me datë 12 dhjetor të vitit 2021, numri i përfituesve për këtë nënmasë ka qenë 2,785.

Të dhënat e publikuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, paraqesin që 2,985 persona kanë ndërruar jetë si pasojë e infektimit me COVID-19 në vendin tonë.¹ Andaj shuma e dedikuar për këtë masë rrjedhimisht nuk është e mjaftueshme për të subvencionuar të gjitha familjet që mund të përfitojnë nga kjo masë. Nëse të gjithë familjet që kanë humbur familjarin e tyre si pasojë e COVID-19 aplikojnë dhe aplikimet e tyre cilësohen si të suksesshme, shuma e nevojshme për të subvencionuar të gjitha familjet është 4,477,500.00 Euro.

¹ Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, COVID-19, e qasshme në <https://datastudio.google.com/embed/reporting/2e546d77-8f7b-4c35-8502-38533aa0e9e8/page/MT0qB>, (qasur në dhjetor, 2021)

NËNMASA 3.2

MBËSHTETJA PËR PENSIONISTËT DHE FAMILJET ME ASISTENCË SOCIALE

Me anë të kësaj mase Ministria e Financave Punës dhe Transfereve synon rritjen e mirëqenies sociale dhe krijimin e një shoqërie të barabartë. Kjo duke mbështetur familjet që pranojnë asistencë sociale me 30% mbi nivelin e rregullt dhe duke paguar shtesat për pensionistë, ashtu që asnjë pension të mos jetë nën 100 Euro. Kjo nënmasë ka të parapara **17 milionë Euro**. Këto shtesa parashihet të aplikohen deri në fund të këtij viti fiskal.

Çka do të përfitojnë qytetarët nga kjo nënmasë?

Përfituesit e skemave pensionale në muajin nëntor dhe deri në fund të këtij viti fiskal do të mbështeten me nga 100 Euro shtesë mbi pensionin e rregullt dhe shtesën aktuale. Në anën tjetër, përfituesit e skemave sociale në muajt nëntor dhe dhjetor do të përfitojnë dyfishin e pagesës së rregullt dhe shtesës aktuale, shtesë e cila gjithashtu aplikohet si pjesë e masës 3.2 të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Këto shtesa nuk janë të mjaftueshme për të përmbushur obligimet financiare të pensionistëve dhe familjeve me asistencë sociale, por gjithsesi paraqesin një mbështetje për të tejkaluar vështirësitë e pandemisë.

Sa është numri i familjeve përfituese nga kjo nënmasë?

Janë gjithsej rreth 330 mijë familje të cilat i përkasin kësaj kategori e të cilat mund të përfitojnë nga kjo nënmasë e Pakos së Ringjalljes Ekonomike.

Pandemia ka afektuar të gjitha shtresat shoqërore, por kjo kategori është ndër më të prekurat. Kjo për faktin që në këtë periudhë të vështirë për të gjithë globin, problemet për këtë kategori vetëm sa janë shtuar. Prandaj një mase e tillë dhe mbështetja e cila synohet të transmetohet tek qytetarët përmes kësaj mase është e duhur dhe tenton të lehtësojë tejkalimin e krizës aktuale.

NËNMASA 3.3 → REFORMIMI I SKEMËS SË ASISTENCËS SOCIALE

Skema e Asistencës Sociale ka për qëllim për të ndihmuar financiarisht familjet, anëtarët e të cilëve janë ose me aftësi të kufizuara të përhershme ose në moshën mbi 65 vjeçare, si dhe për familjet të cilët kanë vetëm një apo asnjë familjar të punësuar dhe i kanë të hyrat nën standardin e caktuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në publikimin Statistikat e Mirëqenies Sociale, TM1 2021, nga skema e ndihmës sociale kanë përfituar 26,298 familje me gjithsej 105,296 anëtarë, dhe nga skema për mbështetje materiale familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara kanë përfituar 2,405 familje. Këto shifra pasqyrojnë më së miri se sa e nevojshme ka qenë që këto kategori të përfshihen në Pakon e Ringjalljes Ekonomike.


Pandemia COVID-19 ka treguar që jo të gjithë familjet që kanë nevojë janë të përfshira në skemën e asistencës sociale, andaj është e nevojshme që kjo skemë të zgjerohet. Duke përfshirë më shumë familje në Skemën e Asistencës Sociale, rritet mirëqenia sociale dhe krijohen kushte më të barabarta për të gjithë. Nënmasa e tretë e masës së tretë, e quajtur Reformimi i Skemës së Asistencës Sociale ka të ndara **12 milionë Euro** për këtë qëllim. Ashtu siç potencohet edhe në Pakon e Ringjalljes Ekonomike, kjo nuk është shuma përfundimtare përmes të cilës synohet një reformë e tillë, pasi që edhe një shumë prej 47 milionë Eurove do të financohet përmes një projekti në bashkëpunim me Bankën Botërore për të arritur një reformë të suksesshme, të zgjeruar dhe gjithpërfshirëse.



NËNMASA 3.4 → KUPONË USHQIMI PËR FAMILJET NË NEVOJË

Afektimi nga pandemia COVID-19 ka qenë i vërejtur më së shumti tek grupet shoqërore më të cenueshme. Familjet të cilat përballen me probleme ekonomike dhe të ardhura të vogla janë dëmtuar rëndë nga kjo pandemi. Problemet e paraqitura tek kjo shtresë kanë detyruar që të përpilohen masa të veçanta të cilat targetojnë direkt ndihma në tejkalimin e problemeve. Një ndër këto masa është edhe nënmasa e katërt e masës së tretë, e quajtur Kuponë ushqimi për familjet në nevojë. Gjithsej kjo masë ka të alokuara **4 milionë Euro** dhe synon të ndihmojë rreth 7,500 familje më në nevojë, ku këtyre familjeve do t'u shpërndahen kuponë ushqimi në vlerë prej 60-70 euro.

Nënmasa 3.4 parasheh edhe ofrimin e ndihmës për kuzhinat popullore. Edhe këto biznese kanë përjetuar dëme si rrjedhojë e pandemisë, andaj inkuadrimi i tyre në pakon e ndihmave aktuale afekton direkt edhe qytetarët të cilët sigurojnë ushqim përmes këtyre kuzhinave. Masa është operacionalizuar dhe tashmë është mbyllur afati për aplikim. Përmes saj është tentuar mbështetje për kuzhinat popullore për personat në nevojë. Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve tashmë ka nënshkruar marrëveshjet e mbështetjes financiare me përfaqësuesit e organizatave përfutuese (14) me datë 9 nëntor 2021, përmes të cilave do të ndihmohen kuzhinat popullore të cilat ofrojnë shërbime për qytetarët më në nevojë.



NËNMASA 3.5 → PAGESA PËR LEHONAT E PAPUNA

Qëllimi i kësaj mase është forcimi i pozitës financiare të gruas në shoqëri, e cila rrjedhimisht përkthehet në rritje të mirëqenies sociale, barazisë shoqërore dhe lehtësim të krizës pandemike. Lehonat si një kategori e ndjeshme shoqërore, e cila është afektuar nga pandemia në mënyra të ndryshme, si për shembull humbja e vendit të punës, rrezikimi i shëndetit dhe dëmtimi i mirëqenies, janë përfshirë në Pakon e Ringjalljes Ekonomike. Për këtë kategori shoqërore është dedikuar një nënmasë e veçantë e quajtur Pagesa për lehonat e papuna dhe e cila mbështetet me **3 milionë Euro**.

Kush përfiton nga kjo nënmasë?

Lehonat të cilat figurojnë si të papuna në Administratën Tatimorë të Kosovës për dymbëdhjetë (12) muajt e fundit para ditës së lindjes së foshnjës.

Çka do të përfitojnë lehonat nga kjo nënmasë?

Sipas masës 3.5, lehonat e papuna në dymbëdhjetë (12) muajt e fundit do të përfitojnë mbështetje financiare 170 Euro për 6 muaj, ndërsa ato të punësuar do të përfitojnë mbështetje financiare 170 Euro për 3 muaj, krahas kompensimit të rregullt të pushimit të lehonisë.

Si duhet të aplikohet për këtë nënmasë?

Nënat e reja mbi 18 vjeç që kanë lindur foshnjën nga data 1 gusht 2021 mund të aplikojnë për mbështetje duke plotësuar formularin për aplikim në platformën elektronike eKosova me të dhënat personal të aplikueses, numrin e llogarisë bankare dhe numrin personal të foshnjës.

NËNMASA 3.6 → MBËSHETJA E LIKUIDITETIT FAMILJAR

Përmes kësaj nënmasë synohet krijimi i kushteve më të lehtësuara për tejkalimin e krizës pandemike, duke ndihmuar likuiditetin familjar dhe duke mbështetur mbulimin e shpenzimeve sezonale dhe shpenzimeve të tjera. Mbështetja do të bëhet përmes kredive konsumuese, të cilat mund të jenë me vlerë deri në 3,000.00 Euro. Kreditë e tilla do të shërbejnë për mbulimin e shpenzimeve sezonale, mbulimin e kredive dhe stabilizimin ekonomik të familjeve kosovare. Për këtë nënmasë janë të ndara **10 milionë Euro** nga Pako e Ringjalljes Ekonomike.


Çka janë kreditë konsumuese?

Kredia konsumuese është kredi e cila ofrohet për qytetarët për të blerë mallra, mbuluar shpenzimet sezonale dhe për të kryer obligimet tjera financiare. Këto lloj kredish janë të rëndësishë së veçantë në periudhën pandemike, për arsye se kriza e shkaktuar ka shtuar problemet dhe ka hapur hallka të reja financiare në pothuajse secilën familje.

Cilat janë përfitimet e masës 3.6 dhe kush mund të përfitojë?

Të gjithë personat që kanë marr kredi konsumuese deri në shumën 10,000.00 Euro, nga data 1 tetor 2021 e tutje, mund të aplikojnë për subvencionim të kredisë. Shuma e subvencionimit për secilin aplikues i cili aprovohet si i përfitues nga kjo nënmasë është 10% e shumës totale të kredisë, deri në maksimumin prej 300.00 Euro.

Përfituesit potencial të masës së tretë të Pakos së Ringjalljes Ekonomike



* Për nënmasën 3.5 nuk ka të dhëna të sakta se sa është numri potencial i përfituesve nga Pako e Ringjalljes Ekonomike

* Për nënmasën 3.6, përfitues mund të jenë të gjithë personat që marrin kredi konsumuese deri në shumën 10,000.00 Euro nga data 1 tetor 2021 e tutje

- Nënmasës 3.1 “Mbështetja për familjet që kanë humbur kryefamiljarin”, duhet t’i shtohen edhe 477,500.00 Euro. Kjo pasi që me mjetet e alokuara tani nuk mund të subvencionohen të gjitha familjet që kanë humbur familjarin si pasojë e COVID-19. Nëse të gjithë këto familje kanë aplikime të suksesshme për këtë nënmasë, mjetet nuk mjaftojnë dhe rrjedhimisht nuk përmbushet me sukses masa 3.1. Kjo masë e cila tenton të mbështet familjet më të prekura nga pandemia duhet të zbatohet plotësisht, andaj alokimi i mjeteve do të duhej të ishte i paraparë ashtu që të mbuloj të gjitha këto familje.
- Të zgjatet afati për aplikim për mbështetje për këtë masë. Afati deri me datë 30 nëntor nuk ishte i mjaftueshëm që të gjitha familjet të aplikojnë. Por, mbi të gjitha, mbështetja për familjet që kanë humbur familjarin nuk duhet të jetë ekskluzivisht e bazuar në aplikimet e këtyre familjeve. Një qasje proaktive e Qeverisë nevojitet në mënyrë që identifikimi dhe mbështetja e familjeve të bëhet nga ana e Qeverisë dhe jo që këto familje të detyrohen të futen në procedura aplikimi.
- Të zgjatet periudha e përfitumeve për familjet me asistencë sociale dhe pensionistët. Si kategori mjaft të cënueshme dhe të dëmtuara nga pandemia, ndihmat vetëm për muajin nëntor dhe dhjetor nuk janë të mjaftueshme. Inkurajojmë që fonde të reja të alokohen në mënyrë që subvencionimi i qytetarëve që i përkasin këtyre kategorive, të vazhdoj edhe pas përfundimit të vitit fiskal. Stina e dimrit shton obligimet financiare për qytetarët andaj mundësi i subvencionimit të kësaj nënmase deri në përfundimin e stinës së dimrit do të lehtësonte obligimet ekonomike dhe shpenzimet sezonale.
- Reformimi i Skemës së Asistencës Sociale sipas nënmasës 3.3 duhet të jetë një proces i cili duhet të strukturohet në atë mënyrë që të ketë gjithpërfshirje të familjeve që kanë nevojë për ndihmë dhe me parimin që të mos lihet askush mbrapa. Skema e Asistencës Sociale aktuale nuk përfshin të gjithë personat në nevojë dhe pandemia vetëm sa ka shtuar vështirësitë për këto familje. Si grupe të cënueshme që janë, Qeveria e Kosovës duhet të ofrojë mbështetje të shtuar dhe të mundohet që të përmirësojë mirëqenien sociale dhe barazinë shoqërore për këtë kategori të shoqërisë kosovare.
- Nënmasa 3.6 Mbështetja e likuiditetit familjar të monitorohet nga afër për keqpërdorime të kredive konsumuese. Të angazhohen inspektime dhe kontrollime se a po përdoren kreditë për mbulimin e hallkave të dëmtuara ekonomike të qytetarëve, apo vetëm po përdoren për përfitimin e subvencionimit nga ana e Qeverisë së Kosovës. Nuk mjafton vetëm operacionalizimi i masave, por edhe inspektimi i tyre pasi që keqpërdorimet e mundshme mund të ndikojnë në mbarëvajtjen e të gjithë pakos.



B | T | D The Balkan Trust
for Democracy
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

“Ky projekt mbështetet nga Balkan Trust for Democracy (BTD) një projekt i Fondit Gjerman Marshall të SHBA-ve dhe popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe zbatohet nga Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet apo opinionet e BTD, GMF, USAID ose Qeverisë së SHBA-së.”